

Bono për Diasporën

INVESTO NË VENDIN TËND

PËR FITO
INTERES



Ministria e Financave,
Punës dhe Transfereve

Investim i Garantuar

Niveli më i lartë i sigurisë. Kthimi i investimit është i garantuar nga Republika e Kosovës.

Bono 3 dhe 5 vjeçare

Afatizimet e ofruara:

3 vite me normë afatizimi 1.2%

5 vite me normë afatizimi 2.2%

Likuiditet

Investimi mund të shitet nëse paratë u duhen para përfundimit të afatit.

Shitje para afatit

Nuk ka ndëshkim. Ju e mbani interesin e fituar. Por në treg mund të ketë lëvizje të normave të interesit dhe ju mund të humbni ose fitoni në transaksion.

Interes çdo 6 muaj

Interesi paguhet çdo 6 muaj deri në përfundim të afatizimit.

Pa Tatim

Interesi i fituar është i liruar nga tatimi

Vetitë Kryesore



Çka janë Bonot për Diasporën?

Bonot për Diasporën janë Bono për shitje me pakicë, lloj i letrave me vlerë të borxhit, të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, dhe të dedikuara për diasporën tonë. Ky produkt është zhvilluar me qëllim që të lehtësojë investimin e kursimeve në bono thesari, duke e bërë procesin të ngjashëm me atë të afatizimit të parave në bankë.

Kur ju afatizoni paratë në bankë, ju në fakt i jepni hua bankës, e cila pastaj paratë tuaja i shfrytëzon për dhënien e kredive për personat tjerë.

Ngjashëm, edhe Bonot për Diasporën (letrat me vlerë) janë instrument financiar përmes të cilit Republika e Kosovës merr hua nga investitorët që të financojë projekte zhvillimore.



Kush mund të investojë në Bono për Diasporën?

Bonot për Diasporën emetohen gjatë sezonit kur shumica e bashkatdhetarëve tanë kthehen në vendlindje. Mirëpo nuk ka kufzime sa i përket asaj se kush mund të blejë. Të gjithë personat privatë (me përjashtim të bizneseve), përfshirë edhe shtetasit e Kosovës, kanë të drejtë të investojnë në Bono për Diasporën, pavarësisht vendbanimit apo nënshtetësisë.



Sa është i sigurt investimi im?

Kthimi i borxhit që merr Republika e Kosovës është i garantuar me Ligjin mbi Borxhin Publik, i cili i jep përparësi kthimit të borxhit ndaj të gjitha shpenzimeve tjera të Qeverisë. Prandaj investimi në Bono për Diasporën mund të konsiderohet si investimi më i sigurt në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, të gjitha letrat me vlerë të emetuara nga Republika e Kosovës janë në formë elektronike, dhe të dhënat e pronësisë ruhen në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Prandaj nuk ekziston mundësia për humbje apo falsifikim të pronësisë.



Si mund të investoj në Bono për Diasporën?

Republika e Kosovës shitjen e Bonove do ta bëjë përmes bankave partnere në vend. Për të blerë Bono për Diasporën, ju fillimisht duhet të keni të hapur llogari bankare në njërin nga bankat partnere. Në rast se keni llogari të hapur tashmë, mjafton të shkoni në njërin nga degët e bankës tuaj që të bëni blerjen e Bonove.



Bankat partnerë për investime në Bono?

Bazuar në memorandumimin për bashkëpunim në mes të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Bankave Komerciale, investitorët mund të investojnë në Bonot për Diasporën përmes këtyre bankave partnere:

Banka Ekonomike

Banka Kombëtare Tregtare

Banka për Biznes

NLB Banka

ProCredit Bank

Raiffesen Bank Kosova



Sa është fitimi nga investimi në Bono për Diasporën?

Varësisht nga afati që ka, një Bono për Diasporën paguan edhe interes/kamatë të caktuar. Afatizimi (maturimi) **3** vjeçar ka normë vjetore **1.20%**, ndërsa afatizimi **5** vjeçar ka normë vjetore **2.20%**.

Përparësia e Bonove për Diasporën është se interesi **paguhet çdo 6 muaj** deri në përfundimin e afatit.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se interesi i fituar nga Bonot është i liruar nga tatimi.



Çka nëse më duhen paratë para afatit?

Bonot për Diasporën mund të tregtohen edhe në tregun e letrave me vlerë.

Prandaj në rast se paratë u duhen para se të përfundojë afati i investimit, ju mund t'i shisni Bonot dhe t'i ktheni paratë tuaja. Për t'i shitur Bonot, kontaktoni bankën tuaj dhe pyesni për mundësinë dhe çmimin e shitjes.

